

LIGJ
Nr.9631, datë 30.10.2006

PËR ARTIN SKENIK

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Ky ligj përcakton parimet e përgjithshme, rregullat e organizimit, të funksionimit, realizimit dhe financimit të artit skenik, si dhe të drejtat e detyrimet e subjekteve, që kanë për objekt veprimtarie artin skenik.

Neni 2
Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është nxitja, mbështetja dhe zhvillimi i krijimtarisë e i veprimtarisë së subjekteve të artit skenik për krijimin, ekzekutimin dhe kultivimin e veprave e të gjinive skenike.

Neni 3
Subjektet dhe fusha e zbatimit

Ky ligj zbatohet për të gjithë personat fizikë e juridikë, vendas e të huaj, që ushtrojnë veprimtari në fushën e prodhimit dhe të shfaqjes së veprës artistike skenike në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 4
Përkufizime

Në zbatim të këtij ligji, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Art skenik” është përfshirja e gjinive, të cilat gërshetojnë në strukturën e tyre arte të ndryshme dhe që janë të destinuara, detyrimisht, të shfaqen për publikun në skena të hapura ose të mbyllura.
2. “Teatër” është hapësira ku zhvillohet dhe ajo çka ndodh në shfaqje, e gjallë dhe e drejtpërdrejtë, ndërmjet artistit dhe spektatorit.
3. “Vepër skenike” është krijimi i gjallë artistik i një teksti, platforme, partiture ose libreti, të përfunduar dhe të mundshëm për t'u shfaqur, për së gjalli dhe drejtpërdrejt, në publik.
4. “Veprimtari skenike” është krijimi, prodhimi, ekzekutimi, tregtimi dhe shfrytëzimi i veprës artistike skenike, zhvillimi i vlerave kombëtare, edukimi dhe shërbimet e lidhura me këtë veprimtari.

5. "Artist i skenës" është personi, që përcjell te publiku një vepër, e cila është e paracaktuar të komunikojë për së gjalli dhe drejtpërdrejt me të.

Janë të tillë edhe bashkëpunëtorët e veprës skenike, që shfaqen në publik.

6. "Fondi publik i artit skenik" është fondi i miratuar në ligjin vjetor të buxhetit, si dhe të ardhurat e tjera të njohura me ligj, të paracaktuara për financimin e veprimtarisë së artit skenik.

7. "Projekt artistik" është çdo ide, e zhvilluar dhe e plotësuar deri në nivelin e shpjegimit të kuptueshëm, duke përfshirë të gjitha elementet e nevojshme për realizimin e saj artistikisht. Projekti artistik mund të jetë i sferës së prodhimit, të edukimit, të promovimit, mund të jetë tradicional ose alternativ, privat ose shtetëror.

8. "Aplikim" janë kërkesat e subjektit për financimin nga fondi publik i artit skenik, në mbështetje të legjislacionit në fuqi.

9. "Mbështetje financiare" është masa e financimit të një projekti artistik, dhënë një subjekti të caktuar nga fondi publik i artit skenik.

10. "Sezon artistik" është periudha e kufizuar e kohës, gjatë së cilës përcillet në publik veprimtaria skenike në vazhdim.

11. "Subjekte private të artit skenik" janë personat fizikë ose juridikë, vendas apo të huaj, që funksionojnë në mbështetje të ligjeve nr.7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare" dhe nr.8788, datë 7.5.2001 "Për organizatat jofitimprurëse", që ushtrojnë veprimtari të artit skenik.

KREU II INSTITUCIONET E ARTIT SKENIK

Neni 5

Ndarja e institucioneve të artit skenik

1. Institucionet e artit skenik janë subjekte publike dhe private.
2. Institucionet publike të artit skenik ndahen në qendrore dhe vendore.
3. Në institucionet publike qendrore të artit skenik përfshihen:
 - a) Teatri Kombëtar;
 - b) Teatri Kombëtar i Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor;
 - c) Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë;
 - ç) Qendra Kombëtare e Artit Skenik.
4. Në insitucionet publike vendore të artit skenik përfshihen institucionet e artit skenik, në varësi të njësisë së qeverisjes vendore.

KREU III INSTITUCIONET PUBLIKE QENDRORE TË ARTIT SKENIK

Neni 6

Statusi dhe qëllimi i veprimtarisë

1. Institucionet publike qendrore të artit skenik janë persona juridikë, publikë, me statusin e institucionit qendror, në varësi të Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.
2. Institucionet publike qendrore të artit skenik kanë si qëllim dhe objekt kryesor të veprimtarisë së tyre nxitjen dhe zhvillimin e artit skenik, si krijimtari shpirtërore, ruajtjen e identitetit kulturor kombëtar, nëpërmjet studimit, edukimit, prodhimit, paraqitjes dhe shpërndarjes së veprave skenike; eksperimentimin e formave të reja të shprehjes skenike; realizimin e veprave artistike të autorëve shqiptarë dhe të huaj, për të gjitha grupet e shtresat sociale; shkëmbimet teatrore ndërkombëtare, turnetë, festivalet, manifestimet intelektuale, riprodhimin audioviziv dhe botimet.

Neni 7

Drejtimi dhe funksionimi i institucioneve publike qendrore të artit skenik

1. Drejtimi dhe funksionimi i institucioneve publike qendrore të artit skenik realizohen në përputhje me dispozitat e këtij ligji, të akteve nënligjore në zbatim të tij, statutit të institucionit, rregullores së bordit artistik dhe rregullores së brendshme të funksionimit.

2. Statuti propozohet nga titullari i institucionit dhe miratohet nga Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

3. Rregullorja e funksionimit të brendshëm të institucionit të artit skenik miratohet nga titullari, ndërsa rregullorja e bordit artistik miratohet nga vetë bordi në mbledhjen e parë të tij.

4. Struktura dhe organika e institucioneve publike qendrore të artit skenik miratohen me urdhër të Kryeministrit, pas propozimit të Ministrisë të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

5. Institucioni ka stemën, vulën dhe selinë, të cilat përcaktohen në statut.

Neni 8

Organet drejtuese

Drejtimi dhe organizimi i veprimtarisë administrative dhe artistike të institucioneve publike qendrore të artit skenik realizohen nga titullari i institucionit dhe bordi artistik.

Neni 9

Titullari

1. Institucioni publik qendror i artit skenik, sipas nenit 6, drejtohet nga titullari.

2. Emërimi, lirimi ose shkarkimi i titullarit të institucionit publik qendror bëhen me vendim të Këshillit të Ministrave, pas propozimit të Ministrisë të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

Neni 10

Bordi artistik

1. Bordi artistik është organizëm kolegjal pranë institucionit publik qendror të artit skenik. Struktura e bordit dhe mënyra e përzgjedhjes së anëtarëve përcaktohen në statutin e institucionit. Titullari i institucionit thërret, organizon dhe drejton mbledhjet e bordit artistik.

2. Bordi artistik funksionon në përputhje me ligjin nr.8480, datë 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale”.

3. Anëtarët e bordit artistik janë personalitete të shquara të fushës së artit dhe të veprimtarive shoqërore, që kanë lidhje me të. Anëtarët nuk mund të jenë të punësuar në institucionin pranë të cilit funksionon ky bord. Mandati i tyre është 3-vjeçar, me të drejtë ripërsëritjeje vetëm një herë.

4. Anëtari i bordit artistik, përpara marrjes së çdo vendimi, është i detyruar të nënshkruajë një deklaratë, me anë të së cilës deklaron se nuk ka konflikt interesi, në kuptim të ligjit nr.9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” dhe të dispozitave të tjera ligjore në fuqi.

5. Bordi artistik, si rregull, mbledhet jo më pak se dy herë gjatë një sezoni artistik.

6. Masa e shpërblimit të anëtarëve të bordit përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 11

Kompetencat e bordit artistik

Bordi artistik i institucionit qendror të artit skenik ka këto detyra:

- a) miraton, në mbledhjen e parë, rregulloren e funksionimit të tij, e cila propozohet nga titullari i institucionit;
- b) vendos repertorin artistik vjetor të institucionit, në përputhje me politikën e Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve;
- c) miraton projektet artistike, në përputhje me repertorin e vendosur;
- ç) miraton kriteret dhe kushtet e shpërblimit të vlerës artistike;
- d) miraton paraqitjen ose pjesëmarrjen e institucionit në festivale e manifestime të tjera, duke përcaktuar edhe projektin pjesëmarrës.

Neni 12

Burimet e financimit

Burimet e financimit të institucioneve publike qendrore të artit skenik janë:

- a) Buxheti i Shtetit:
 - i) financime nga Buxheti i Shtetit për shpenzimet operative e administrative, investimet dhe pajisjet teknike për administratën;
 - ii) financimi i përfutur nga Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për realizimin e repertorit vjetor skenik;
 - b) të ardhurat nga administrimi i kapitaleve fizike të tyre, si të arkivave, literaturës etj. dhe nga shitja e biletave;
 - c) të ardhurat e siguruara nga shitja e veprave skenike të prodhuara, tek të cilat ushtrohen të drejtat ekonomike dhe tregtare;
 - ç) të ardhurat e tjera, të siguruara nga aplikime në burime ligjore financimi për projekte të ndryshme dhe të veçanta, në përputhje me statutet e tyre;
 - d) sponsorizimet dhe donacionet;
 - dh) të ardhura të tjera të ligjshme.
- Përdorimi i të ardhurave bëhet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

Neni 13

Marrëdhëniet juridike të punës

Marrëdhëniet juridike të punës në institucionin publik qendror të artit skenik rregullohen me Kodin e Punës të Republikës së Shqipërisë dhe me statutin e rregulloren e brendshme të institucionit.

Neni 14

Dispozitat e kreut III nuk gjejnë zbatim për Qendrën Kombëtare të Artit Skenik.

KREU IV

QENDRA KOMBËTARE E ARTIT SKENIK, ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI

Neni 15

Qendra Kombëtare e Artit Skenik

1. Qendra Kombëtare e Artit Skenik (QKAS) është person juridik, publik, me statusin e institucionit qendror, në varësi të Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, që ka objekt të veprimtarisë menaxhimin e fondit publik për mbështetjen financiare të projekteve të

paraqitura nga institucionet publike vendore të artit skenik ose nga persona fizikë apo juridikë, privatë, vendas ose të huaj, që kanë objekt verpimtarie artin skenik.

2. Struktura dhe organika përcaktohen me urdhër të Kryeministrit, në bazë të propozimit të Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

3. Organizimi dhe funksionimi përcaktohen në statut, i cili miratohet nga Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, në bazë të propozimit të Kryetarit të Qendrës.

Neni 16
Kryetari

QKAS-ja drejtohet nga Kryetari, i cili emërohet, lirohet ose shkarkohet me vendim të Këshillit të Ministrave, pas propozimit të Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

Neni 17
Kompetencat e Kryetarit

Kryetari i Qendrës Kombëtare të Artit Skenik ka këto kompetenca:

- a) përgatit, thërret dhe drejton mbledhjet e bordit artistik të QKAS-së;
- b) zbaton vendimet e bordit artistik dhe lidh kontratat me subjektet përfituese të fondeve financiare;
- c) përcakton tarifat e aplikimit dhe të regjistrimit të subjekteve të artit skenik;
- ç) përfaqëson institucionin në marrëdhëniet me të tretët;
- d) ushtron kompetencat për drejtimin e veprimtarisë administrativo-ekonomike të QKAS-së dhe të gjitha kompetencat që nuk i janë dhënë shprehimisht bordit artistik.

Neni 18
Bordi artistik i QKAS-së

1. Bordi artistik është organizëm kolegjal pranë QKAS-së dhe funksionon në përputhje me ligjin nr.8480, datë 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale”.

2. Bordi artistik përzgjedh dhe klasifikon projektet e artit skenik nga pikëpamja e vlerave artistike dhe ekonomike.

3. Bordi artistik merr vendime me shumicë të thjeshtë votash të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të pranishëm në mbledhje.

4. Vendimi i bordit artistik përfshin miratimin e projektit artistik dhe fondin financiar përkatës në të gjitha fushat e artit skenik dhe për të gjithë aplikantët, që kanë të drejtë të përfitojnë fonde, sipas këtij ligji.

5. Bordi artistik mblidhet jo më pak se dy herë në vit.

6. Masa e shpërblimit të anëtarëve të bordit përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 19
Përbërja e bordit artistik të QKAS-së

1. Bordi artistik përbëhet nga 7 anëtarë, të cilët zgjidhen në bazë të propozimeve të mëposhtme:

- a) një anëtar nga bordi artistik i Teatrit Kombëtar;
- b) një anëtar nga bordi artistik i Qendrës Kombëtare të Kulturës për Fëmijë;
- c) një anëtar nga bordi artistik i Teatrit Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansambllit Popullor;
- ç) një përfaqësues i Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve;

- d) një kritik i artit skenik, i propozuar nga Akademia e Shkencave;
 - dh) një përfaqësues nga Fakulteti i Artit Skenik;
 - e) një përfaqësues i Fakultetit të Muzikës në Akademinë e Arteve.
2. Anëtarët e bordit artistik kanë mandat 3-vjeçar, me të drejtë ripërsëritjeje vetëm një herë.
3. Anëtarët e bordit artistik janë personalitete të fushës së artit dhe të veprimtarive të tjera shoqërore që kanë lidhje me të.
4. Përbërja nominative e bordit paraqitet nga Kryetari i Qendrës Kombëtare të Artit Skenik dhe miratohet nga Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

Neni 20

Fondi publik i Qendrës Kombëtare të Artit Skenik

Fondi i Qendrës Kombëtare të Artit Skenik është publik, me zë më vete në Buxhetin e Shtetit. Ky fond administrohet sipas rregullave të përcaktuara me udhëzim të Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe për mbështetjen e projekteve artistike nuk i nënshtrohet legjislacionit për prokurimet publike.

Neni 21

Kompetencat e Qendrës Kombëtare të Artit Skenik

Qendra Kombëtare e Artit Skenik ka këto kompetenca:

- a) zbaton politikat shtetërore në fushën e artit skenik, në përputhje me këtë ligj dhe me aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi;
- b) shpall publikisht, në fillim të çdo viti, fondin publik të artit skenik jo më vonë se një muaj pas përcaktimit me hollësi të Buxhetit të Shtetit;
- c) planifikon fondin publik të artit skenik, sipas gjinive të artit, mbështet dhe financon, plotësisht ose pjesërisht, projekte artistike të paraqitura nga subjektet publike të artit skenik vendor apo subjektet private të artit skenik;
- ç) paraqet çdo vit kërkesat për mbështetje buxhetore të fondit publik të artit skenik, si dhe mbikëqyr përdorimin e financimeve nga subjektet e mbështetura prej saj;
- d) mbledh, përpunon dhe u shpërndan subjekteve të artit skenik të dhëna të vlefshme në fushat e prodhimit, të edukimit dhe të promovimit të veprimtarisë skenike;
- dh) nxit, bashkëpunon, financon ose bashkëfinancon projekte e programe në fushën e edukimit, të prodhimit dhe shpërndarjes së veprimtarive skenike kombëtare dhe ndërkombëtare;
- e) regjistron subjektet e artit skenik, sipas kërkesave dhe kritereve profesionale të miratuara nga bordi artistik;
- ë) siguron asistencë teknike, në shërbim të rritjes cilësore dhe të standardizimit të aplikimit të projekteve teatrore.

Neni 22

Burimet e financimit

Burimet e financimit të Qendrës Kombëtare të Artit Skenik janë:

- 1. Financime nga Buxheti i Shtetit, për financimin e projekteve të artit skenik, për investimet, pajisjet teknike për administratën, si dhe për shpenzimet operative administrative.
- 2. Të ardhurat nga tarifatat për regjistrimin e subjekteve aplikuese për financim të projekteve të artit skenik.
- 3. Sponsorizimet dhe donacionet.
- 4. Të ardhura të tjera të ligjshme.

Neni 23

Kushtet dhe kriteret për gëzimin e së drejtës së aplikimit

1. Institucioni publik vendor i artit skenik, personi fizik apo juridik, privat, vendas ose i huaj, gëzon të drejtën e aplikimit për financim nga fondi publik i artit skenik vetëm pasi është regjistruar në Qendrën Kombëtare të Artit Skenik.

Kushtet dhe kriteret e aplikimit përcaktohen dhe miratohen me udhëzim të Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

2. Subjektet private të artit skenik, të cilat përfitojnë financime nga fondi publik i artit skenik, janë të detyruara të kontraktjnë artistë dhe bashkëpunëtorë për realizimin e projektit.

3. Shpenzimet administrative të një projekti artistik, të financuar nga fondi publik i artit skenik, nuk duhet të kalojnë 10 për qind të të gjithë vlerës së financimit.

Neni 24

Llojet e financimeve nga Qendra Kombëtare e Artit Skenik

Institucioni publik vendor i artit skenik, personi fizik apo juridik, privat, vendas ose i huaj, gëzon të drejtën të kërkojë nga Qendra Kombëtare e Artit Skenik financim, të pjesshëm ose të plotë, për një projekt skenik afatgjatë, afatmesëm dhe afatshkurtër.

Përcaktimet për këto lloj projektsh miratohen nga bordi artistik i QKAS-së.

Neni 25

Të drejtat pasurore për veprën e realizuar nga subjekti privat i artit skenik

Pasi ka shlyer detyrimet, që burojnë nga financimi, parashikuar në kontratën me Qendrën Kombëtare të Artit Skenik, subjekti përfitues i fondit, me statusin e institucionit publik vendor të artit skenik, personi fizik apo juridik, privat, vendas ose i huaj, gëzon të drejtën pasurore dhe jopasurore dhe të përdorimit të lirë të veprës teatrore, në përputhje me dispozitat e ligjit nr.9380, datë 28.4.2005 “Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të”.

KREU V

INSTITUCIONET PUBLIKE VENDORE TË ARTIT SKENIK

Neni 26

Institucionet publike vendore të artit skenik dhe statusi i tyre

1. Institucionet publike vendore të artit skenik janë institucione buxhetore, që krijohen ose shndërrohen në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në zbatim të këtij ligji, me nismën, vullnetin e pushtetit vendor dhe janë në varësi të njësisë së pushtetit vendor.

2. Statuti i institucionit publik vendor të artit skenik propozohet nga bordi artistik dhe miratohet nga këshilli i njësisë së qeverisjes vendore përkatëse.

3. Përbërja e bordit artistik të institucionit publik vendor miratohet nga këshilli i njësisë së qeverisjes vendore. Anëtarët e bordit kanë mandat 3-vjeçar, me të drejtë ripërsëritjeje.

4. Institucioni publik vendor i artit skenik e ka selinë në njësinë administrative vendore.

Neni 27

Burimet e financimit të institucioneve publike vendore të artit skenik

Burimet e financimit të institucionit publik vendor të artit skenik sigurohen nga:

- a) financime nga Buxheti i Shtetit për pushtetin vendor për shpenzimet administrative;
- b) buxheti i pushtetit vendor për kulturën;

- c) të ardhurat e siguruara nga projektet fituese në Qendrën Kombëtare të Artit Skenik;
- ç) të ardhurat nga shitja e veprës skenike;
- d) të ardhurat nga biletat, shërbimet që institucioni u bën të tretëve;
- dh) sponsorizimet e donacionet;
- e) të ardhura të tjera të ligjshme.

Neni 28

Zgjedhja e titullarit

Titullari i institucionit publik vendor të artit skenik emërohet nga këshilli i njësisë së qeverisjes vendore dhe përzgjidhet ndërmjet dy kandidaturave të propozuara nga kryetari i njësisë së qeverisjes vendore. Procedurat e emërimit të tij përcaktohen në statut, i cili miratohet nga këshilli i njësisë së qeverisjes vendore.

Neni 29

Marrëdhëniet juridike të punës

Marrëdhëniet juridike të punës në institucionin publik vendor të artit skenik rregullohen me Kodin e Punës të Republikës së Shqipërisë, si dhe me aktet nënligjore, statutin dhe rregulloren e brendshme.

Neni 30

Teatri metropolitan

1. Me “Teatër metropolitan” kuptohet statusi i veçantë, që i jepet një institucioni publik vendor të artit skenik në bazë të historikut, vlerave të larta artistike dhe kontributit të dhënë në kulturën kombëtare.

2. Procedurat, kushtet dhe kriteret e dhënies së statusit “Teatër metropolitan” përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU VI

SUBJEKTET PRIVATE TË ARTIT SKENIK

Neni 31

Subjektet e artit skenik privat

1. Subjektet e artit skenik privat funksionojnë në mbështetje të ligjeve nr.7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare” dhe nr.8788, datë 7.5.2001 “Për organizatat jofitimprurëse”.

2. Subjektet e artit skenik privat detyrohen të regjistrohen në QKAS dhe në organet tatimore, në përputhje me legjislacionin fiskal në fuqi, në mënyrë që të përfitojnë financime për projekte private skenike nga fondi publik i artit skenik.

KREU VII

TARIFAT E SHPËRBLIMIT TË CILËSISË ARTISTIKE

Neni 32

Masa dhe kriteret e shpërblimit

1. Masa e shpërblimit të vlerës artistike në artin skenik dhe për kontributin e angazhimit të përkohshëm në projektet kulturore bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Kushtet, kriteret dhe masa e shpërblimit për rezultate të larta, të arritura në konkurrime

ndërkombëtare në artin skenik, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU VIII
DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 33

Teatri Kombëtar për Fëmijë bashkohet me Qendrën Kombëtare Kulturore të Fëmijëve dhe krijohet institucioni publik qendror “Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë”.

Neni 34

Teatri Kombëtar i Operës dhe Baletit bashkohet me Ansamblin Kombëtar të Këngëve dhe Valleve Popullore dhe krijohet “Teatri Kombëtar i Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor”.

Neni 35

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 9, 10, 16, 18, 30 e 32.

2. Kryeministri miraton brenda 6 muajve, në bazë të propozimit të Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve strukturën dhe organikën e Qendrës Kombëtare të Kulturës për Fëmijë dhe të Teatrit Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor, sipas pikës 4 të nenit 7 të këtij ligji.

Neni 36

Shfuqizimet

Ligji nr.8578, datë 10.2.2000 “Për teatrin” dhe të gjitha aktet nënligjore, që bien në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 37

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5117, datë 20.11.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**